



Datë: 25.03.2026

Numër Protokolli: 1513/2026

A.nr.113/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.113/2026, të datës 30.01.2026, të parashtruar nga ankuesi I.V, kundër organit të punësimit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike-administrative “*transferim i përkohshëm*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 25.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura administrative e nisur sipas ankesës me numër A.nr.113/2026, e datës 30.01.2026, e parashtruar nga ankuesi I.V.

A r s y e t i m

Ankuesi I.V (*tutje referuar ankuesi*), më datë 30.01.2026, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 30.01.2026, e regjistruar nën shenjën A.nr.113/2026, kundër Vendimit me Nr.2392/2025, të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 06.02.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa, ky i fundit, më datë 06.03.2026, i ka përcjellë shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ka bazë të mjaftueshme ligjore si dhe ekzistojnë rrethana të reja të cilat e plotësojnë kushtin që vendimmarrja ankesën e ankuesit të **pezullohet**, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rezulton se Ankuesi sipas Aktit të Emërimit me Nr.24 të datës 29.12.2015, është i punësuar në pozitën Zyrtar Administrativ në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Sektorin Qendra për Pajisje me Dokumente, Agjencia e Regjistrimit Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

- Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 31.12.2025, ka nxjerr Vendim me Nr. 2392/2025, me të cilin ka bërë transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita Zyrtar Administrativ në Qendrën për Pajisje me Dokumente në pozitën Asistent Administrativ në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Klinikë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kundërshton Vendimit me Nr.2392/2025, të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pretendon se transferimi është bërë fillimisht pa njoftim paraprak me shkrim; Vendimi nuk është arsyetuar mbi gjendjen faktike përkatësisht nuk ka dhënë arsyetim nëse punonjësi i transferuar plotëson kriteret e pozimit ku transferohet; Transferimi duhet bazohet në atë se transferimi i përkohshëm për interes të institucionit është prej gjashtë muaj deri në 12 muaj gjatë dy viteve.

Këshilli i Këshillit në procedurë të shqyrtimit të ankesës A.nr.113/2026, ka gjetur se organi i punësimit ende pa përfunduar proceduar ankimore lidhur me kontestimin e Vendimit Nr.2392/2025, të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme për transferimin e përkohshëm, ka ndërprerë marrëdhënien e punës së ankuesit mbi bazën e Vendimit me Nr. 265/2026, të datës 04.02.2026, të Komisionit Disiplinor, e me të cilin vendim ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore *“largim nga shërbimi civil”*, akt ky i kontestuar nga ankuesi përmes ankesës A.nr.285/2026 të datës 12.03.2026, dhe si e tillë përben çështje paraprake, kështu që, në kuptim të nenit 85, paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: “çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”*, Kolegji vendosi që të pezullohet procedura administrative e iniciuar sipas ankesës me numer A.nr.113/2026 e dates 30.01.2026, deri në vendosje të ankesës me numër A.nr.285/2026 të datës 12.03.2026.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.113/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit I.V;
- Organit të punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MPB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.